

VENDIM
Nr. 887, datë 4.11.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË BASHKISË KURBIN E CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e granteve nga fondi i rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të godinës së Bashkisë Kurbin, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, në vlerën 296 969 254.28 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet e tetë) lekë.

2. Bashkia Kurbin caktohet si njësi zbatuese për rindërtimin e godinës së Bashkisë Kurbin, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin.

3. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, i transferohet Bashkisë Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe